



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Orahovac

	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINETI PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No <u>02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)</u>		
Nr./Br./No <u>224</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>117</u>		
Data/Datum/Date <u>27 / 2 / 23</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT - RREGULLLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke u bazuar në Nenin 7, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, për vënien në konsultim publik **DRAFT - RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT**, Zyra për Informim, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Rahovecit, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Për draft - rregulloren për Menaxhimin e Meturinave në territorin e Komunës së Rahovecit

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për Draft - rregulloren për Menaxhimin e Meturinave në territorin e Komunës së Rahovecit, u publikua me datë: 15.2.2023, në ueb - faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/02/njoftim-publik-draft-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-territorin-e-komunes-se-Rahovecit.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

Më 3.2.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft - Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit, me datë 15.2.2023, mirëpo në mungesë të pjesëmarrësve, nuk u mbajt. <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/02/NJOFTIM-PUBLIK-2.pdf>

Më 15.2.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft - rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit.

Njoftimi është publikuar në ueb - faqen zyrtare të komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

1. Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ncës/njoftim-publik-draft-rregulloren-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-territorin-e-komunes-se-rahovecit/>

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Publikimi-facbook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid023FAvjVSdHEeBA5aVd9varsLdu4ameBbrnhco6ivgZx7XYvCP4dXUQHjsofgZu5jFl&id=100067252380999&mibextid=Nif5oz

2. Rikujtim:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02f4nZeHAERUZZm8nXbTZ3edeLPËëGypxijE6T2RdtYëBxakpz8UEUp5LXv2nDrëxël&id=100067252380999&mibextid=Nif5oz

3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41751>

Më 20.2.2023, përmes rrjetit social **viber**, janë njoftuar kryetarët e fshatrave - lagjeve të komunës së Rahovecit.

KONSULTIMI PUBLIK

Me datë: **22.2.2023** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të kompanive të pastrimit; dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në veçezën <https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/u-mbajt-konsultimi-publik-i-draft-rregullores-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-territorin-e-komunes-se-rahovecit/>

Konsultimi publik filloi në orën 10:10.

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNES SË RAHOVECIT

Përparim Krasniqi: Përshëndetje të gjithëve. Fillimisht dua t'ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë konsultim publik. Dua t'i falënderoj të gjithë kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve dhe zyrtarët komunalë të pranishëm. Unë jam Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Rahovecit. Jemi këtu në konsultimin publik për Draft - rregulloren për menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit, kjo Draft-rregullore është në konsultim publik nga data: 3.2.2023, deri më datë: 3.3.2023. Deri në këtë datë, ne pranojmë komentet tuaja për Draft - rregulloren, më pas do t'i nënshtrohet procedurave të tjera të përcaktuara me ligj. Pra, pas konsultimit publik do të shkojë në Kuvend për miratim.

Për herë të parë është bërë kategorizimi i taksës për mbeturina, që ndahet në tri zona: Rahovec, Brnjak dhe Xërxë.

Poashtu, ju njoftoj se prej janarit të vitit 2024, pagesa e taksës për mbeturina do të bëhet në komunë.

Kjo ishte në pika të shkurtra, e hapi tani diskutimin për këtë Draft-rregullore, kushdo që ka ndonjë koment lidhur me këtë Draft-rregullore, tani fjalën e keni ju. Të gjitha komentet që keni pastaj do t'i fusim në këtë Draft - rregullore.

Afrim Dina: Përshëndetje për të gjithë juve, unë jam Afrim Dina, përfaqësues i fshatit Celinë, e shikova te Draft – rregullorja, te çmimet për ekonomi familjare, 4.50 euro për individë dhe 6 euro për njësi familjare, a janë çmime aktuale apo si rritje e taksës?

Përparim Krasniqi: Ministria e Mjedisit e ka rekomanduar rritjen e taksës.

Mensur Gashi, fshati Sapniq: 117 shtëpi në fshatin tonë janë pa asnjë njeri, për arsye se jetojnë në mërgim, - si ta paguajnë taksën?

Përparim Krasniqi: Sipas rregullores, taksën e paguajnë vetëm për periudhën që janë këtu.

Ilir Kryeziu, fshati Retijë: Pyetje- Kërkesë e qytetarëve është që me vetë pagesë a mundën të vendosin kontenjerë në shtylla elektrike?

Përparim Krasniqi: Do të koordinohemi me kompanitë e pastrimit të asaj zone që t'i mbledhin mbeturinat.

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN
E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNES SË RAHOVECIT**

I ftoi të gjitha kompanitë që të sjellin shkresë zyrtare, nëse kanë ndonjë sygjërim për ndarjen e kategorizimeve.

Kujtim Sopjani, fshati Dobidol: Jo, të gjithë janë të regjistruar.

Përparim Krasniqi: Kemi të dhëna për ata që nuk janë të regjistruar, anadaj prej 2024, do të rregullohet kjo çështje.

Duke u bazuar në afatet ligjore të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të konsultimeve publike, dokumenti u publikua në ueb - faqen e Komunës së Rahovecit, që qytetarët të kenë mundësi të njihen me draft - rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit, si dhe të japin sugjerime dhe vërejtje deri në miratimin e saj në Kuvend Komunal.

Konsultimi publik përfundoi në orën **10:35**.

Adresat të cilat u publikuan për të mbledhur komente janë: Bjondina.ramaj@rks-gov.net, Perparim.krasniqi@rks-gov.net dhe skender.hamza@rks-gov.net.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Republika e Kosovës
Kryetaria e Komiteteve të Përbashkëta të Komunave të Kosovës
Kryetaria e Komiteteve të Përbashkëta të Komunave të Kosovës

Është bërë konsultim publik për rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit.

No.	Emri	Adresa	No. i tel.	Shënime
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

Republika e Kosovës
Kryetaria e Komiteteve të Përbashkëta të Komunave të Kosovës
Kryetaria e Komiteteve të Përbashkëta të Komunave të Kosovës

Është bërë konsultim publik për rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit.

No.	Emri	Adresa	No. i tel.	Shënime
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				

Pjesëmarrës: Agim G. Jashari

Kryetari:

Data: 02.02.2023

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN
E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

FOTOGRAFI



Përgatiti: Zyrtar për Informim

